

**1 QERSHORI**



**DITA  
NDËRKOMBËTARE E  
FËMIJËVE**

## KOSOVA KA DEMOKRACI PËRFAQËSUESE

RINESA (11), ERBLIN (10), ADENIS (11), DIANA (11), LESINA (10), LORESA (11), ANITA (10),  
ALMEDINA (11)



### Demokracia është sistem i qeverisjes në të cilin populli udhëheq përmes votave të lira

Është pjesë e përditshmërisë sonë, por nuk është që mendojmë shumë për të. Zakonisht ndodh që të flasim për të vetëm kur kemi ndonjë orë mësimore. Ani pse të gjitha të drejtat që ne i gëzojmë janë falë saj. Kjo është demokracia. Sistemi më i mirë i qeverisjes, sistemi ku të gjithë qytetarë pa dallime trajtohen në mënyrë të barabartë. Aty ku nuk ka dallime në mes të moshuarit dhe fëmijës, në mes të djalit dhe vajzës, etj.

Kur themi dallime, në mendje i kemi të drejtat e njeriut, si për shembull, të drejtën e fjalës së lirë. A mendoni ju të dashur lexues se qytetarët të cilët janë më të rinj në moshë nuk duhet ta gëzojnë të drejtën e fjalës së lirë, veç pse janë më të rinj? Sipas nesh jo, në asnjë mënyrë nuk duhet të ekzistojnë dallime të këtij lloji. Sepse këtë e kërkon demokracia. Po flasim për demokracinë, por ende nuk i treguam se nga ka ardhur ky sistem.

Demokracia për herë të parë është paraqitur në Athinë në vitin 507 para erës sonë. Nëse dëshironi të dini se a ka pësuar ndryshime demokracia që prej kohës kur për herë të parë u shfaq, ne iu themi që po. Madje, ndryshime shumë të mëdha. Nëse flasim për elementet e saj që janë: barazia, liria, respekti, toleranca, etj; asokohe pothuajse asnjëra prej tyre nuk ishin siç janë sot. Përveç kësaj, gjatë asaj kohe ka ekzistuar vetëm demokracia e drejtpërdrejtë. Ndërsa, tash kemi edhe demokracinë përfaqësuese. Dallimi mes demokracisë

përfaqësuese dhe asaj të drejtpërdrejtë është se në këtë të fundit është populli ai që merr vendimet në mënyrë direkte. Kurse, tek demokracia përfaqësuese përfaqësuesit e popullit janë ata të cilët marrin vendime në emër të popullit.


Vendi ynë, Kosova është shembulli ideal për këtë lloj të demokracisë. Prindërit tanë, me vota të lira i zgjedhin ata persona për të cilët mendojnë se do t'i përfaqësojnë më së miri kërkesat e tyre. „Kështu thonë edhe familjarët e mi“, tha Anesi. Ai tregoi po ashtu, që kohë pas kohë prindërit e tij i thonë: „Kur të rritesh edhe pak do të kuptosh më mirë rëndësinë e zgjedhjes së përfaqësuesve.“ Për ta kuptuar më mirë unë, ata bënë krahasim me zgjedhjen e kryesisë së klasës. „Ju i zgjedhni ata që ta përfaqësojnë klasën, kurse ne i zgjedhim deputetët që të na përfaqësojnë të gjithë neve, qytetarëve“, thanë ata. „Është demokracia, që na e mundëson këtë“, tha së fundmi Lorea.



Përfaqësuesit e ardhshëm

# VOTA ËSHTË E LIRË

ERIONA (11), ENESA (11), ERISA (10), ELMEDINA (11), DREN (11), BLEND (11), AGRON (11), ELISA (11)



## Me shumë kënaqësi ju ftojmë të lexoni artikullin tonë, punuar nga duart tona të vogla

Tashmë, për më pak se 4 javë, ne po e përfundojmë klasën e V-të. Jemi shumë optimist se suksesi ynë do të jetë shembullor. Mirëpo, jemi pak të mërzhitur se do të ndahemi nga mësuesja jonë. Shpresat për një sukses akoma më të madh janë shumë të fuqishme. Zemrat tona rrahin fort kur e mendojmë të ardhmen,



por mësuesja jonë e dashur na përkrah si gjithmonë. Që nga shtatori do të jemi me mësime të ndryshme, të cilët do të ligjërojnë lëndë të ndryshme. Kjo do të jetë diçka e re për ne.

Gjithsesi, për të shënuar përfundimin e klasës së V-të, ne kemi zgjedhur që të shkojmë tek lojërat në Milenium. Kjo ka qenë një zgjedhje që e kemi bërë të gjithë nxënësit e klasës sonë së bashku. Si klasë, bashkarisht ne e kemi zgjedhur edhe kryetarin e klasës sonë. Mirëpo, sot këtu në Punëtori e kuptuam se ekziston

një dallim në mes të zgjedhjeve që i bëjmë çdo ditë dhe procesit zgjedhor. Procesi zgjedhor është procesi më i rëndësishëm demokratik. Në këtë proces ne votojmë/zgjedhim personat të cilët përfaqësojnë vendin tonë. Për të marrë pjesë në këtë proces, ne duhet të kemi së paku 18 vjet. Kjo për arsye se vota jonë nuk do të ndikojë vetëm në jetën tonë, por edhe në jetën e të gjithë qytetarëve të Kosovës. Procesi zgjedhor me rregull duhet të ndodhë çdo 4 vjet. Sigurisht, ka raste kur kemi zgjedhje të parakohshme apo të jashtëzakonshme. Vota duhet të jetë e lirë dhe nuk duhet të imponohet asnjëherë, në asnjë rrethanë.

Ne kemi dy lloje të zgjedhjeve. Janë zgjedhjet qendrore në të cilat i zgjedhim deputetët, si dhe zgjedhjet komunale në të cilat i zgjedhim kryetarët e komunave përkatëse dhe asamblistët. Ne dëshirojmë që ju gjithmonë të merrni pjesë në procesin zgjedhor, sepse vota juaj është një dhe e vetmja.




Sot, më të lumtur se kurrë




Demokracia është në duart tona. Të punojmë të gjithë për ndërtimin e saj




Vota është e drejta, përgjegjësia dhe liria më e dashur që ne qytetarët e kemi



Ne zgjedhim të votojmë dhe gjithmonë të jemi pjesëmarrës në udhëheqjen e vendit tonë



Voto edhe ti! Vetëm kështu ne tregohemi qytetarë të përgjegjshëm



Ashtu sikurse Dielli që e ndriçon planetin Tokë, demokracia e ndriçon jetën tonë



Me shumë dëshirë jetojmë në demokraci, sepse kemi të drejta dhe liri




Të lumtur dhe të gëzuar që jemi pjesë e projektit më të madh për demokracinë „Demos-ti“

# ÇDO VEPRIM I YNI, NDIKON EDHE TEK TË TJERËT

DRIN (11), AGNESA (10), EARTA (10), KLEA (11), ALEJSA (11), JONILA (10), AMAZONA (11)

## KATEGORIZIMI I MBETURINAVE



**Kjo javë ishte e mbushur me shumë gëzim dhe lumturi, sepse në komunën tonë, shumë organizata kanë qenë pjesë e organizimit „Prishtina Lexon“. Gjatë kësaj jave, fytyrat tona ishin të buzëqeshura, sepse kemi bërë aktivitete shumë të mira në lidhje me leximin, bashkë me disa qytetarë aktiv**

Qytetari aktive do të thotë kur një grup qytetarësh ndihmojnë komunitetin e tyre me shumë veprime bujare. Kjo do të thotë se këta individë nuk punojnë vetëm për interesa personale, por edhe për rrethin shoqëror.

Ne si të rinj, kemi shumë plane për të ardhmen, plane të cilat kanë lindur nga ajo çka ne kemi mësuar në Punëtorinë „Demos-ti“.

Ne mund të quhemi qytetarë aktiv nëse në të ardhmen marrim pjesë në procesin zgjedhor, duke votuar për përfaqësuesit e komunës apo edhe të Kuvendit. Në vazhdim po i paraqesim disa ide tona përmes të cilave ne mund të kontribuojmë për komunitetin tonë. Shoqja jonë Alejsa, ka dëshirë që në të ardhmen të hap kurse pa pagesë për të rinjtë, që ata të mësojnë se si të shkruajnë një letër motivuese, si të jenë më

të përgatitur në intervista të punës, e shumë gjëra të tjera. Një veprim i tillë, do t'i ndihmojë të rinjtë që të jenë më të përgatitur për tregun e punës.

Ideja tjetër është e shoqes sonë Jonilës. Ajo mendoi që në komunën tonë, kontenjerët e mbeturinave duhet të jenë më të mëdhenj dhe të kategorizuar për mbeturina të materialeve të ndryshme. Do të ishte edhe më mirë nëse këta kontenjerë do të ishin elektronik, ku edhe nëse qytetarët gabojnë dhe i hedhin mbeturinat në vendin e gabuar do të aktivizohej një alarm që i vetëdijëson ata se kanë gabuar. Në të ardhmen, ata nuk do të bënin një gabim të tillë.

Këta shembuj tregojnë se ne jemi të gatshëm të shërbejmë në komunitet, dhe besojmë shumë që edhe pjesa tjetër e të rinjve mendon njëjtë.



Edhe dhurimi i librave është qytetari aktive



Ne jemi nën shërbimin e komunitetit tonë



## IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI  
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPËSTINA  
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



**ERSTE Stiftung**

Redaktohet nga  
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit  
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga  
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:  
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Zenel Hajdini“  
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: V-6  
Website: www.demos-ti.org Vendi: Prishtinë